



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Profitech" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Furnizim me pajisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe pajisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi " , Nr. i prokurimit- 632-22-8070-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-085-121, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Profitech" SH.P.K, e dt.10.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe pajisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi " , Nr. i prokurimit- 632-22-8070-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-085-121, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 07.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 07.10.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.10.10.2022, Operatori Ekonomik "Profitech" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: Furnizim me pajisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe pajisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi " , Nr. i prokurimit- 632-22-8070-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-085-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se nuk e keni parë Letrën standarde për sqarimin e tenderit, nuk qëndron sepse po të kishte pengesa në platformën e e-prokurimit, kjo pengës do të ishte për të gjithë operatorët ekonomik e jo vetëm për ju.

Përveç kësaj është tentuar disa herë përmes telefonit të kontaktojmë me ju por nuk i jeni përgjigjur thirrjes, prandaj me të drejtë Zyra e prokurimit ka marrë masat sipas ligjit ndaj jush dhe ka vazhduar me Operatorin ekonomik të radhës.

Pra ne si Autoritet kontraktues nuk e kemi shpërblyer fillimisht Operatorin ekonomik me çmimin më të lartë por kjo ka qenë rezultat i mos përgjigjes suaj ndaj kërkesës së Autoritetit kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

  
**Faton Gutaj**  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës

